

VENDIM
Nr. 168, datë 15.6.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GLOBAL INTERPRISE GROUP” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1722/1 prot., datë 10.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Interprise Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Interprise Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1722 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “c” dhe “d”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “c”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 2, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “b”, “c”, “d” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Rezulton se shoqëria “Global Interprise Group” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën nr. 642 rep., nr. 1977 kol., datë 27.12.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Doma” me kapacitet prodhues 1.695 mw, në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër”;

- Është pajisur me miratimin e pikës së lidhjes së HEC “Doma” me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSHEE sh.a. nr. 1491/2 prot., datë 25.7.2018, me lëndë “Miratim pikë lidhjeje HEC ‘Doma’, për një kapacitet të instaluar prej 1695 kw”;

- Është pajisur me lejen për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor nr. 40 prot., datë 26.12.2023, me nr. serial 000107, të lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor (KBU) Mat, me afat vlefshmërie deri më 26.12.2028;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake nr. AN230620230002, lëshuar më 7.9.2023, komisioni 96, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtim HEC ‘DOMA’”, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapaciteti të instaluar 1695 kw, përfshirë lejen e ndërtimit për objektin “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit ‘Doma’”,

Në kuptim të nenit 9, pika 1.2, germa “b”, pika 1.3, germat “a” dhe “b”, si dhe pika 2.1, germat “a”, “b”, dhe “e”, për qëllime të këtij aplikimi shoqëria duhet të plotësojë dhe sa vijon:

Neni 9. Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Dëshminë e penaltetit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për vetë shoqërinë “Global Interprise Group” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera, në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “b”: Në referencë të përcaktimeve të nenit 8, pika 2 të kontratës, duhet të depozitojë në ERE miratimin përkatës të MIE-s për ndryshimin e vlerës së investimit.

Po ashtu, duhet të depozitojë dokumentacion që vërteton aftësinë financiare të saj për realizimin e projektit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës:

2.1 germa “a”, germa “b” dhe germa “e”:

- të dhënat në lidhje me vitin e ndërtimit të centralit, datën në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit;

- raportimet e dërguara në MIE, në kuadër të ecurisë së projektit, si dhe të përditësojë çdo informacion/dokumentacion vijues, në lidhje me zhvillimin e tij;

- informacion, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Global Interprise Group” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Global Interprise Group” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për

gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti